



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
 Dp. \_\_\_\_\_  
 Dp. \_\_\_\_\_

Nr. Prot. \_\_\_\_\_  
 Br. Prot. \_\_\_\_\_  
 Prot. No. \_\_\_\_\_

Nr. llog. \_\_\_\_\_  
 Bro. stranica \_\_\_\_\_  
 Nr. pages \_\_\_\_\_


DPK

02

03-02/3452/17

24-10-2017

PRISHTINE



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.10.2017, mori:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2460-17, për Zyrtarin e lartë z.Fatbardh Gashi – Prodekan në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, për shkak se i njejtë tashmë nuk ushtron funksion publik, dhe nuk është në mesin e zyrtarëve të lartë publik të shtetit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-2460/17, për Zyrtarin e lartë, z.Fatbardh Gashi, Prodekan në Universitetin “Haxhi Zeka”, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Gashi (DPK-03-02-2471-17), dhe pastaj ai ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar për arsyen e shkresës zyrtare.

Zyrtari i lartë, z.Gashi është deklaruar se ai ka ardhë në Agjencinë kundër Korrupsionit për të bërë deklarin e pasurisë (D.P.-03/5232/17) pas largimit nga funksioni publik, sepse ai tashmë nuk është zyrtar i lartë pasi që ka pushuar mandati i tij prej Prodekani në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.

**II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

  
\_\_\_\_\_  
/ Shaip Havolli /

